

Përmbledhje e politikave

Qasja Ndërsektoriale për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Nivel Lokal



Funded by
the European Union



Përmbledhje e politikave: Qasja Ndërsektorale për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Nivel Lokal

Autorët:

Ljubiša Baščarević - Konsulent i jashtëm
Ekipi i Domovik

Botuar nga:

Domovik
Sutjeska p.n. Mitrovicë e Veriut
E-mail: office@domovik.org
www.domovik.org

Viti i publikimit: 2023

Ky publikim është hartuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përm-bajtja e tij është përgjegjësi e vetme e Domovik dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

Domovik mbështetet me programin e Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) ‘EJA Kosovo’.

Qasja Ndërsektoriale për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Nivel Lokal

Tabela e Përmbajtjes

Historiku/Hyrje	04
Origjina e Qasjes Shumësektoriale - Standardet dhe Praktika Ndërkombëtare	04
Si të krijohen ekipe për të drejtat e fëmijës - Standardet dhe praktikat e brendshme	05
Funksionaliteti i Ekipit Komunal për të Drejtat e Fëmijëve	06
Zbatimi i Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Udhëzimit Administrativ në Komunitatet e Kosovës (shembull i praktikave të mira)	08
Politika ekzistuese dhe Korniza Rregullative në Komunitatet e synuara	08
Konkluzionet	10
Rekomandimet e politikave	11
Rekomandim për anëtarët e ekipit sektorial	13

Historiku/Hyrje

Respektimi, mbrojtja dhe përmbushja e të drejtave të fëmijëve integron qasjen ndërsektoriale dhe përpjekjet e përbashkëta të akterëve kryesorë në fushat e qeverisjes (politikave dhe rregulloret), kujdesin shëndetësor, arsimin, mbrojtjen sociale dhe sundimin e ligjit. Një koordinim efektiv, bashkëpunim produktiv dhe komunikim i mirë ndërmjet ofruesve të shërbimeve janë shpesh aspekte kritike për krijimin e një mjedisi të përshtatshëm për fëmijët, i cili është i favorshëm për zhvillimin e fëmijës dhe kontribuon efektisht në mirëqenien e fëmijës.

Kjo përmbledhje e politikave ka për qëllim si të shërbejë si udhëzues për mbrojtjen efektive të të drejtave të fëmijëve në nivel lokal për akterët përkatës në qeverisje, planifikimin e politikave, zhvillimin dhe zbatimin e politikave dhe programeve aktive në fusha specifike të rëndësishme për fëmijët dhe familjet e tyre. Ajo përmban referenca për standardet ndërkombëtare dhe vendore dhe analizat e praktikave më të mira që mund të përshtaten dhe të përdoren në kontekstet lokale të komunave në Kosovë. Konkretisht, këtu propozohen një sërë masash dhe veprimesh konkrete për ofrimin e përmirësimit të qasjes dhe cilësisë së shërbimeve për fëmijët në komunat e Zveçanit, Zubin Potokut dhe Leposaviqit, duke marrë parasysh të gjithë faktorët e brendshëm dhe të jashtëm që mund të krijojnë pengesa, por edhe duke theksuar mundësitë potenciale për përmirësimin e qasjes dhe cilësisë së këtyre shërbimeve për fëmijët në nivel komunitar. Ky dokument thekson rëndësinë e respektimit të një zhvillimi holistik të fëmijëve dhe të ofrimit të shërbimeve të integruara në mënyrë koherente.

Origjina e Qasjes Multisektoriale - Standardet dhe Praktika Ndërkombëtare

Konventa e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës është instrument 'i gjallë' i të drejtave të njeriut, i cili integron plotësisht karakteristikat e të drejtave të njeriut të parapara në të drejtat e fëmijëve, duke i përcaktuar ato si **të drejta të pandashme, të ndërvarura dhe të ndërlidhura** të fëmijëve. Kjo nënkupton që të drejtat e fëmijëve janë të ndërlidhura thelbësisht dhe nuk mund të konsiderohen të izoluara nga njëra-tjetra. Këto karakteristika të të drejtave të fëmijëve janë në thelb të qasjes multisektoriale për zhvillimin e fëmijëve.

Në udhëzimin për të drejtat në fëmijërinë e hershme, Komiteti i OKB-së për të Drejtat e Fëmijëve u kujton shteteve palë se "e drejta për mbijetesë dhe zhvillim mund të zbatohet vetëm në një mënyrë gjithëpërfshirëse, nëpërmjet zbatimit të të gjitha dispozitave të tjera të Konventës, duke përfshirë të drejtat për shëndetin, ushqyerje adekuate, sigurim social, një standard të përshtatshëm jetese, një mjedis të shëndetshëm dhe të sigurt, edukim dhe lojë (nenet 24, 27, 28, 29 dhe 31), si dhe nëpërmjet respektimit të përgjegjësive të prindërve dhe ofrimit të asistencës dhe shërbimeve cilësore (nenet 5 dhe 18). Që në moshë të re, vetë fëmijët duhet të përfshihen në aktivitete që promovojnë ushqyerjen e shëndetshme dhe një mënyrë jetese të shëndetshme dhe pa sëmundje".

Në dekadat e fundit, koncepti i ofrimit të shërbimeve të integruara të zhvillimit të fëmijëve është promovuar dhe zbatuar gjerësisht nga organizatat ndërkombëtare për të drejtat e fëmijëve (UNICEF, OBSH), OJQ-të (Save

the Children) dhe qeveritë, veçanërisht për fëmijët 0-6 vjeç (zhvillimi në fëmijëri të hershme - ZhFH). Kjo kornizë çoi drejt përmirësimit të qasjes dhe ofrimit të një sërë shërbimesh në kujdesin shëndetësor dhe të ushqyerit, arsimit dhe mbrojtjen sociale. Qasja fillimisht u aplikua në disa nga vendet më të zhvilluara si SHBA-të (1965), por edhe në vendet me të ardhura të ulëta dhe në zhvillim si programi i nisur në vitin 1975 në Indi¹, ose "Oportunidades" i projektuar dhe iniciuar në Meksikë², në vitin 1997.

Në qasjen multisektoriale ndaj zhvillimit të fëmijëve, mund të ketë gjithashtu një sektor udhëheqës, por sektorë të tjerë kontribuojnë në arritjen e rezultateve të sektorit kryesor. Kjo referencë buron nga qasja e Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSh) e cila "përkufizon shëndetin multisektorial si një marrëdhënie midis një pjese të sektorit shëndetësor dhe një sektori tjetër të krijuar për të arritur rezultate shëndetësore".

Në fushën e mbrojtjes së fëmijëve, UNICEF-i ka zhvilluar dhe zbaton qasje shumësektoriale për t'i dhënë fund punës së fëmijëve, e cila përfshin planifikimin në arsim, mbrojtjen sociale dhe mbrojtjen e fëmijëve, bazuar në analizat e natyrës së shumëanshme të sfidave në këtë fushë. Një shembull tjetër i UNICEF-it përfshin qasjet shumë-sektoriale për adresimin e praktikave të dëmshme që prekin vajzat në Afrikën Lindore dhe Jugore³, më konkretisht duke trajtuar gjymtimin gjenital të femrave dhe martesat e fëmijëve. Kjo qasje përfshinte akterë shumëdisiplinorë dhe bashkëpunim ndërmjet akterëve në nivele të shumta, si ministritë e qeverisë, agjencitë ndërkombëtare, donatorët, organizatat e shoqërisë civile, institucionet fetare dhe komunitetet, si dhe në shumë sektorë të ndryshëm, përfshirë arsimin, shëndetësinë, drejtësinë, mbrojtjen sociale, etj.

Si të krijohen ekipe për të drejtat e fëmijës - Standardet dhe praktikat e brendshme

Progres kritik në kornizën ligjore dhe institucionale të Kosovës për mbrojtjen e fëmijëve, është bërë me miratimin e Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijëve, i cili përcakton krijimin e qasjes multisektoriale për mbrojtjen e fëmijëve dhe përmbushjen e të drejtave të fëmijëve, si në nivel qendror ashtu edhe në nivel lokal. Qasja multisektoriale kërkon përkushtim dhe llogaridhënie të vërtetë të të gjithë akterëve pjesëmarrës, së bashku me përfshirjen e tyre proaktive dhe buxhetim të mjaftueshëm dhe të qëndrueshëm. Koordinimi dhe komunikimi cilësor me shumë shtresa dhe menaxhimi i bazuar në rezultate të programit janë parakushtet kryesore për efektivitetin e sistemit gjithëpërfshirës në vend.

Në **Kapitullin III**, sipas **nenit 9**, Ligji për Mbrojtjen e Fëmijëve u cakton rolet në mbrojtjen e fëmijëve akterëve të ndryshëm institucionalë në nivel qendror duke përfshirë Avokatin e Popullit, ministritë përkatëse, Zyrën për Qeverisje të Mirë, Komitetin Ndërministror për të Drejtat e Fëmijës dhe Këshillin për të drejtat e fëmijës. Në nivel lokal, strukturat dhe mekanizmat kyç përgjegjës institucional përfshijnë komunën, departamentet e saj përkatëse, Qendrën për Punë Sociale dhe Ekipin për të Drejtat e Fëmijës.

1 <https://wcd.nic.in/integrated-child-development-services-icds-scheme>

2 <https://www.heart-resources.org/topic/early-childhood-development/#conception>

3 <https://www.unicef.org/esa/media/9101/file/Multisectorial-approaches-ESA-2021.pdf>

Neni 17 i Ligjit rregullon përbërjen e Komitetit Ndërmintor për të Drejtat e Fëmijëve. Komiteti kryesohet nga Kryeministri dhe përfaqësohet nga ministritë në nivel ministror. Në cilësinë e anëtarëve vëzhgues marrin pjesë përfaqësuesi i Komisionit Parlamentar për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, Avokati i Popullit, dy (2) përfaqësues nga këshillat studentorë, shefi i Zyrës së UNICEF-it në Kosovë dhe një përfaqësues i shoqërisë civile.

Nenet 18-19 përcaktojnë rolet dhe përgjegjësitë e Këshillit për të Drejtat e Fëmijës dhe përbërjen e tij. Këshilli ka një rol këshillues për Komitetin Ndërmintor për të Drejtat e Fëmijës me një detyrë të rëndësishme në bashkëpunimin multisektorial. Këshilli për të Drejtat e Fëmijëve përbëhet nga 21 përfaqësues të ministrive dhe agjencive të ndryshme qeveritare, me Kryesues Drejtorin e ZQM-së dhe nënkryetar, shefin e Divizionit të Shërbimeve Sociale në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Funksionaliteti i Ekipit Komunal për të Drejtat e Fëmijëve

Neni më i rëndësishëm i Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijëve për rekomandimet e kësaj politike është neni 20, për Ekipin për të Drejtat e Fëmijës.

Paragrafi 20.1 thotë se Ekipi për të Drejtat e Fëmijëve në nivel politik vendimmarrës do të themelohet në të gjitha komunat e Kosovës.

Paragrafi 20.2 i nenit më tej përcakton përgjegjësitë kryesore të Ekipit, të cilat përfshijnë përcaktimin, koordinimin dhe monitorimin e masave dhe aktiviteteve prioritare që do të ndërmerren nga komuna për përmirësimin e mbrojtjes së fëmijëve dhe të drejtave të fëmijëve si dhe koordinimin dhe monitorimin e zbatimit të politikave dhe masave për zbatimin e këtij Ligji.

Paragrafi 20.3 përcakton që Komuna do t'i krijojë të gjitha kushtet e nevojshme për Ekipin për të Drejtat e Fëmijës për të kryer aktivitetet nga paragrafi 20.2 i këtij neni. Kjo është dispozita kryesore që përcakton detyrime të qarta ndaj autoriteteve vendore për të funksionalizuar Ekipin, për të siguruar burimet buxhetore të nevojshme dhe për të mbështetur ndërtimin e kapaciteteve të tij. Zbatimi i këtij neni në praktikë pasqyron vullnetin dhe angazhimin politik për përmbushjen e të drejtave të fëmijëve dhe krijimin e kushteve më të mira për zhvillimin dhe mirëqenien e fëmijës.

Sistemi i përpunimit dhe menaxhimit të rasteve individuale është në thelb të qasjes për mbrojtjen e fëmijëve. Ky ligj në nenin 21 të tij rregullon themelimin e **Tryezave Multidisiplinare për Mbështetje në Menaxhimin e Rasteve** në të gjitha komunat e Kosovës, në nivel profesional. Paragrafi 21.2 rregullon procedurat e punës në tryezat multidisiplinare për ndihmë në menaxhimin e rasteve. Puna për rastet individuale drejtohet nga menaxheri i rastit, në koordinim dhe ndërveprim me strukturat dhe shërbimet përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijëve.

Udhëzimi Administrativ (GRK) - NR XX/2022⁴ rregullon nga afër themelimin dhe funksionimin e **Ekipit për të Drejtat e Fëmijës**. Qëllimi i këtij udhëzimi administrativ është përcaktimi i rregullores së punës, përbërjes dhe funksionimit të Ekipit në zbatimin e mandatit të përcaktuar në Ligjin për mbrojtjen e fëmijëve. Udhëzimi

4 <https://konsultimet.rks-gov.net/Storage/Consultations/15-01-02-26012022/3UDHEZ~1.DOC>

gjithashtu përcakton Tryezën e Rrumbullakët Multidisiplinare për Asistencë në Menaxhimin e Rasteve si një grup multidisiplinar që përfshin profesionistë nga institucionet përkatëse të mbrojtjes së fëmijëve dhe akterë të tjerë që përfaqësojnë një sërë disiplinash.

Kapitulli II i këtij dokumenti rregullon themelimin, përgjegjësinë dhe përbërjen e Ekipit. **Neni 6** specifikon një përbërje gjithëpërfshirëse të ekipit me pothuajse të gjitha drejtoritë komunale të përfaqësuara duke përfshirë drejtoritë e shëndetësisë, mirëqenies sociale, arsimit, rinisë, kulturës dhe sportit, si dhe buxhetin dhe financat. Secili ekip ka deleguar anëtarë nga Komisioni për Politikë dhe Financa i Kuvendit Komunal dhe nga Komisioni për Komunitete i Kuvendit Komunal. Anëtarët e tjerë përfshijnë përfaqësues të Njesisë Komunale për të Drejtat e Njeriut, Policisë, Qendrës për Punë Sociale dhe shoqërisë civile.

Një dispozitë e rëndësishme për funksionimin e ekipit është neni 13, i cili përcakton planin e punës së ekipit. Ai tregon se Ekipi harton Planin e Punës për përmbushjen e detyrave në bazë të mandatit të tij, në përputhje me Planin Zhvillimor Komunal duke reflektuar interesat më të mira të fëmijës. Ai hartohet për një periudhë trevjeçare dhe miratohet nga Kuvendi Komunal. Në përputhje me UA, plani duhet të zhvillohet përmes një procesi vlerësimi të politikave, legjislacionit, në përputhje me strategjinë kombëtare për të drejtat e fëmijës, me grupet e fëmijëve të përfaqësuara gjatë procesit të hartimit.

Kapitulli IV i UA përcakton krijimin e një mjedisi miqësor për fëmijët si prioritet për Ekipin duke renditur detyra konkrete nën përgjegjësitë e tij. Pra, ngarkohet me monitorimin proaktiv të planifikimit urban dhe rural, monitorimin e zbatimit të rregullores së ndërtimit dhe standardeve për kontrollin e ndërtimit nga perspektiva e të drejtave të fëmijëve. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet mundësimit të qasjes dhe eliminimit të pengesave për fëmijët me aftësi të kufizuara. Gjithashtu përfshin punën për mbrojtjen e mjedisit lokal, eliminimin e faktorëve që kontribuojnë në ndotjen e mjedisit dhe avokimin për rritjen e hapësirave të gjelbra në zonat ku fëmijët jetojnë dhe ndjekin aktivitete. Ekipi duhet të monitorojë dhe mbështesë ofrimin e arsimit publik parashkollor, fillor dhe të mesëm dhe të sigurojë që çdo fëmijë të përfshihet në arsim cilësor. Ekipi gjithashtu monitoron qasjen në shërbimet në kujdesin parësor shëndetësor dhe regjistrimin civil.

Kapitulli V shpjegon më tej procedurat dhe proceset e brendshme të vendimmarrjes. Neni 5 i këtij kapitulli specifikon se Ekipi takohet së paku një herë në tre (3) muaj, ndërsa takime shtesë mund të organizohen me kërkesë të kryesuesit, ose një të tretës së anëtarëve. Vendimet merren me shumicë të thjeshtë votash të anëtarëve të pranishëm. Neni 20 përcakton që mbledhjet e Ekipit janë të hapura për publikun, por Ekipi mund të vendosë t'i trajtojë disa çështje të ndjeshme në sesione të mbyllura. Kontaktet me publikun dhe mediat bëhen nga Kryesuesi ose Zëvendëskryesuesi.

Në **kapitullin VI, Neni 22** rregullon aspektet e monitorimit dhe raportimit në punën e Ekipit. Roli monitorues i është caktuar Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) dhe Komisionit Parlamentar për të Drejtat e Njeriut, dhe Ekipi u raporton atyre në baza gjashtë mujore. Raporti bazohet në mandatin dhe planin e punës dhe përmbledh të gjitha të arriturat, sfidat, vendimet, konkluzionet, opinionet dhe rekomandimet. **Neni 23** rregullon Buxhetin e Ekipit, i cili është përcaktuar në Planin e Punës për zbatimin e aktiviteteve të Ekipit. Mjetet financiare për Buxhetin sigurohen nga komuna dhe qeveria ose përmes mbështetjes së donatorëve.

Zbatimi i Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Udhëzimit Administrativ në Komunitet e Kosovës (shembull i praktikave të mira)

Pas miratimit të Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe aktit nënligjor mbështetës i cili përmban termat e detajuara të referencës për themelimin dhe funksionalizimin e Ekipit për të Drejtat e Fëmijës nëpër komuna, shumica dërrmuese e komunave në Kosovë (32 nga 38) kanë themeluar Ekipet shumësektoriale për të Drejtat e Fëmijës.

Shembulli i draft planit të punës i zhvilluar për Ekipin në Gjakovë (2024-2026), është analizuar për këtë përmbledhje të politikave. Qëllimet dhe objektivat e tij përcaktohen në fushat e shëndetit dhe mirëqenies sociale, arsimit dhe zhvillimit të fëmijërisë së hershme, kulturës, rinisë dhe sportit, mjedisit dhe hapësirave të gjelbra, si dhe përgjegjësitë e Ekipit (koordinimi, funksionimi, zbatimi, raportimi dhe monitorimi). Çdo zonë është përcaktuar si objektivi strategjik, me analiza të situatës të bëra për secilën prej tyre bazuar në të dhënat bazë të qëndrueshme të mbledhura. Matrica e planit të punës përcakton aktivitetet sipas objektivave specifike të çdo qëllimi strategjik, afatet kohore, alokimet buxhetore, treguesit me vlerat bazë, afatmesme dhe objektive, si dhe rezultatet/produktet e pritshme. Në parim, ky plan pune mund të përsëritet ose të përshtatet për komunitet tjera, në varësi të nevojave të tyre. Për komunitet e synuara të rekomandimeve të kësaj politike Plani i Punës duhet të jetë më pak gjithëpërfshirës dhe i përshtatur për madhësinë, popullsinë dhe buxhetin e tyre në dispozicion.

Politikat ekzistuese dhe Korniza Rregullative në Komunitet e synuara

Edhe pse administrata lokale në Leposaviq, Zveçan dhe Zubin Potok përballlet me shumë sfida praktike dhe politike në funksionim, për shkak të qasjes proaktive dhe iniciativave të anëtarëve të stafit individual dhe mbështetjes së shoqërisë civile, ekzistojnë disa dokumente politikash dhe rregullative që mund të shfrytëzohen gjithashtu si referenca të vlefshme për ngritjen dhe funksionalizimin e Ekipit multisektorial për të Drejtat e Fëmijës në këto komuna.

Në nëntor 2020, OJQ Domovik prodhoi një përmbledhje të politikave mbi **Avancimin e politikave publike për fëmijët bazuar në të dhënat e mbledhura**, në të cilën bëri analiza të situatës në sektorët kyç për të drejtat e fëmijëve dhe përcaktoi problemet dhe pengesat për zhvillimin e fëmijëve. Sipas këtij dokumenti, zhvillimi i politikave publike për fëmijët nuk bazohet në mbledhjen dhe analizën sistematike dhe të organizuar të të dhënave. Rekomandimet kryesore të politikave përfshijnë përmirësimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve publike dhe organizatave të shoqërisë civile, me synimin e shkëmbimit të të dhënave, njohurive, aftësive dhe burimeve të tjera, për të avancuar të drejtat e fëmijëve.

Komuna e Zubin Potokut ka hartuar një draft **Rregullore** për realizimin e të drejtave të fëmijëve, e cila rithekson parimet themelore të KDF-së duke përfshirë mosdiskriminimin, interesin më të mirë të fëmijës, të drejtën për jetë, mbijetesë dhe zhvillim, si dhe të drejtën e fëmijës për t'u dëgjuar dhe marrë në konsideratë perspektiva e tyre. **Nenet 4, 5, 6, 7 dhe 8** integrojnë elementet kryesore të Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Udhëzimin Administrativ dhe përcaktojnë garancitë komunale për përmbushjen e të drejtave të fëmijëve.

Neni 5.3 përcakton listën e palëve përgjegjëse në komunë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve duke përfshirë Kryetarin e Komunës, Kuvendin Komunal dhe administratën, ministritë e linjës, policinë, gjykatën, prokurorinë, mekanizmat koordinues komunal dhe njësitë për të drejtat e njeriut. Përveç kësaj, ato përfshijnë Qendrën për Punë Sociale, institucionet shëndetësore, shkollat, klubet dhe shoqatat sociale dhe sportive, Institucionin e Ombudspersonit, komunitetet lokale, shoqatat e prindërve dhe këshillin e prindërve, organizatat e shoqërisë civile, organizatat ndërkombëtare dhe shoqatat profesionale.

Neni 6 përcakton rolin e Mekanizmit Koordinues i cili duhet të krijojë një mjedis të favorshëm për hartimin e planeve zhvillimore dhe ndarjeve buxhetore dhe të mbikëqyrë zbatimin e programeve përkatëse.

Neni 8.2 më tej rregullon që mekanizmi koordinues komunal të përcaktojë treguesit dhe të mbledhë të dhëna që janë prioritet si për komunën ashtu edhe për fëmijët dhe interesat e tyre. Ky mekanizëm e detyron komunën të raportojë periodikisht për treguesit dhe të ndihmojë në monitorimin dhe vlerësimin e progresit drejt komunës së përshtatshme për fëmijët.

Në parim, komuna e Zubin Potokut ka bërë përpjekjet më të mëdha nga të tri komunat e synuara në zhvillimin e politikave dhe kornizës rregullative për të drejtat e fëmijëve, pasi që është edhe në proces të zhvillimit të **strategjisë komunale për të drejtat e fëmijëve për periudhën 2024-2027**. Ky dokument i politikave lokale do të jetë burim me udhëzime të vlefshme për Ekipin e ardhshëm shumësektorial për të Drejtat e Fëmijës.

Përveç kësaj, **Planet e Veprimit 2022-2024** të zhvilluara nga Qendrat e Mjekësisë Familjare në Zubin Potok, Zveçan dhe Leposaviq për avancimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor për fëmijët dhe prindërit në fushën e infermierisë në komunitet (vizitave në shtëpi) dhe imunizimit, përmbajnë referenca të shkëlqyera për Planin e ardhshëm të Punës së Ekipit për të Drejtat e Fëmijës në sektorin e shëndetësisë.

Konkluzionet

Standardet dhe praktikat ndërkombëtare të rishikuara për këtë përmbledhje të politikave theksojnë nevojën për ofrimin e shërbimeve të integruara dhe qasjen ndërsektoriale ndaj zhvillimit dhe mirëqenies së fëmijëve. Ato janë integruar edhe në kornizën rregullative në Kosovë, më konkretisht në Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijëve i cili përcakton rolet dhe përgjegjësitë e të gjitha palëve relevante të interesit në nivel qendror, me Komitetin Ndërministror për të Drejtat e Fëmijëve që ka primatin për të komunikuar dhe koordinuar politikat, programet dhe proceset përkatëse për të drejtat e fëmijëve.

Një organ tjetër, Këshilli për të Drejtat e Fëmijës ka një rol këshillues pranë Komitetit Ndërministror për të Drejtat e Fëmijës dhe është përgjegjës për të koordinuar dhe monitoruar zhvillimin dhe zbatimin e politikave dhe masave përkatëse për zbatimin e Ligjit për mbrojtjen e fëmijëve, dhe Strategjisë dhe planit kombëtar të veprimit për të drejtat e fëmijëve. Përbërja e tij shkon përtej ministrive të qeverisë dhe zgjeron numrin dhe diversitetin e akterëve që kontribuojnë në mbrojtjen e fëmijëve, duke ua caktuar rolet njëse për mirëqenien sociale, institucioneve të sundimit të ligjit, Avokatit të Popullit dhe të tjerëve. Të dy institucionet konfirmojnë se nevojitet një qasje shumësektoriale për adresimin e të drejtave të fëmijëve në mënyrë gjithëpërfshirëse.

Dispozitat më relevante të Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijëve i referohen krijimit të Ekipit Komunal për të Drejtat e Fëmijës dhe themelimit të Tryezave Multidisiplinare për Mbështetje në Menaxhimin e Rasteve në të gjitha komunat e Kosovës, në nivel profesional. Kjo përsëri thekson qartë nevojën për bashkëpunim ndërsektorial, koordinim dhe komunikim drejt qasjes gjithëpërfshirëse multidisiplinare në trajtimin e mbrojtjes së fëmijëve në nivel lokal.

Udhëzimi Administrativ (GRK) - NR XX/2022 rregullon nga afër dhe në detaje themelimin dhe funksionimin e Ekipit për të Drejtat e Fëmijës. Ky dokument shërben për të udhëhequr të gjitha komunat në themelimin dhe funksionalizimin e këtij ekipi multisektorial, me role dhe përgjegjësi të përcaktuara dhe rregulla të koordinimit ndërmjet akterëve gjithëpërfshirës institucionalë të përfshirë në punën e tyre. Bazuar në shembullin e rishikuar të komunës së Gjakovës, ky plan duhet të mbulojë të gjithë sektorët kritikë për zhvillimin dhe mirëqenien e fëmijëve duke përfshirë shëndetin, arsimin dhe mbrojtjen sociale.

Duke pasur parasysh përbërjen shumëdisiplinore të Ekipit dhe rolin e tij jashtëzakonisht të rëndësishëm për mbrojtjen e fëmijëve dhe respektimin dhe përmbushjen e të drejtave të fëmijëve, është e nevojshme t'u caktohet roli drejtues akterëve përkatës institucionalë dhe të krijohet një kornizë llogaridhënieje për të gjitha subjektet pjesëmarrëse. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për ndarjet buxhetore të cilat duhet të lidhen me aktivitetet në planin e punës, dhe për identifikimin e burimeve dhe qëndrueshmërinë e financimit. Përvoja me përfshirjen e shumë palëve tregon se në disa raste roli i akterëve individualë nuk është i përcaktuar qartë dhe llogaridhënia mund të humbet në moskomunikim dhe moskoordinim. Përvoja, ekspertiza dhe burimet ekzistuese me shoqërinë civile dhe organizatat ndërkombëtare mund të jenë një aset në mbështetje të komunave.

Prandaj, është shumë e rëndësishme që të përforcohen përpjekjet e të gjitha drejtorive relevante komunale, qendrës për mirëqenie sociale, shkollave, ofruesve të kujdesit shëndetësor, institucioneve të sundimit të ligjit dhe OJQ-ve për të drejtat e fëmijëve, në themelimin e Ekipit multisektorial për të Drejtat e Fëmijëve dhe më tej për funksionalizimin dhe avancimin e efektivitetit të punës së tij.

Rekomandimet e politikave

Parakusht për punë serioze në themelimin dhe funksionalizimin e Ekipit për të Drejtat e Fëmijës në komunat e Zveçanit, Zubin Potokut dhe Leposaviqit është gjendja stabile politike dhe administrata plotësisht funksionale komunale në të tri komunat. Aktualisht punojnë me kapacitet të kufizuar, në pritje të zgjidhjes së proceseve politike dhe çështjeve që dalin nga zbatimi i Marrëveshjes së Brukselit. Këto procese janë jashtë kontrollit të akterëve lokal dhe duhet të zgjidhen në nivelin më të lartë politik.

Në rrethana të tilla, vetëm një rekomandim afatshkurtër mund t'u jepet atyre akterëve që punojnë me të paktën disa kapacitete në këtë fazë, duke përfshirë institucionet arsimore, qendrat për mirëqenien sociale, ofruesit e kujdesit shëndetësor, shoqërinë civile dhe organizatat ndërkombëtare, Zyrën Rajonale të Institucionit të Avokatit të Popullit dhe për aq sa është e mundur policia, prokuroria dhe gjykatat lokale. Para se të merren vendimet komunale për themelimin e Ekipit për të Drejtat e Fëmijës, mund të krijohet një trup i përkohshëm koordinues për secilën komunë, me mandat të kufizuar kohor deri në themelimin e organeve funksionale komunale. Ky organ duhet të ndërmarrë disa hapa fillestarë dhe të ndihmojë me analizat e situatës sektoriale për të shërbyer si bazë për zhvillimin e Planit të Punës të Ekipeve të ardhshme komunale për të Drejtat e Fëmijës.

Shërbimet e arsimit dhe kujdesit shëndetësor funksionojnë pothuajse me kapacitet të plotë në këto rrethana sfiduese. Në këtë kontekst, kontributi i tyre në punën e trupit të përkohshëm koordinues mund të jetë mjaft i rëndësishëm, pasi do të vazhdojnë të operojnë në të njëjtën përbërje pavarësisht nga rezultati i zgjedhjeve lokale. Shërbimet për mbrojtjen e fëmijëve në komunat e Leposaviqit, Zubin Potokut dhe Zveçanit ofrohen në bazë të legjislacionit në fuqi të Kosovës, ndërsa një varg shërbimesh shtesë mbështeten përmes ndarjeve buxhetore të Qeverisë së Serbisë. Në interesin më të mirë të përfituesve, ato mund të përdoren në mënyrë plotësuese, duke siguruar disponueshmërinë e burimeve shtesë në këtë fushë.

OJQ-të lokale për të drejtat e fëmijëve duke përfshirë Domovik, "Podrzi me", CARITAS dhe Santa Marija, si dhe organizatat ndërkombëtare UNICEF dhe Save the Children pritet të mbështesin punën e këtij organi të përkohshëm me burimet ekzistuese njerëzore, teknike dhe financiare.

Pas zgjidhjes së ngërçit politik dhe krijimit të administratave funksionale komunale, do të shfaqet nevoja për përpjekje avokuese me autoritetet e sapozgjedhura për të përfshirë krijimin e Ekipit për të Drejtat e Fëmijëve ndër prioritetet kryesore në vitin e parë të qeverisjes. Departamentet e arsimit, shëndetësisë, çështjeve sociale, rinisë, sportit dhe kulturës, dhe komuniteteve dhe kthimit do të kenë primatin së bashku me mbështetjen e departamenteve të financave dhe ekonomisë, mjedisit, infrastrukturës dhe planifikimit hapësinor. Akterë të tjerë të rëndësishëm do të jenë objektet parashkollore, shkollat fillore dhe të mesme, qendrat lokale të mjekësisë familjare, spitalet, Instituti për Shëndet Publik, policia, gjyqësori, Avokati i Popullit, OJQ-të për të drejtat e fëmijëve, UNICEF-i dhe Save the Children. Nga ana legjislative, anëtarët nga Komisioni për Politikë dhe Financa dhe nga Komisioni për Komunitete duhet të delegohen nga Kuvendi Komunal. Në mbledhjen konstituive të Ekipit të thirrur nga Kryetari, është e nevojshme të merret vendimi për themelimin e Sekretariatit të Ekipit.

Siç është përcaktuar qartë në Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijëve, të gjithë pjesëmarrësve duhet t'u caktohen role dhe përgjegjësi në kontribut në punën e Ekipit. Në fillim, çdo departament komunal përmes bashkëpunimit me subjektet e tjera përgjegjëse duhet të ndërmarrë një vlerësim bazë të situatës së të drejtave përkatëse të fëmijëve në sektorin e tij. Kjo do të jetë referencë shumë e rëndësishme për rishikimet dhe vlerësimet e ardhshme dhe do të ofrojë udhëzime se ku nevojiten më shumë përpjekje dhe burime për të arritur standardet e dëshiruara. Ky vlerësim do të integrohet edhe në Planin e Punës, i cili duhet të jetë aktiviteti i parë i Ekipit.

Është shumë e rëndësishme që çdo departament të caktojë një staf të kualifikuar dhe kompetent në Ekip, me përkushtim të demonstruar dhe shpërndarje adekuate të kohës së punës për kontributin në operacionet e Ekipit. Gjithashtu, çdo departament duhet të planifikojë në buxhetin vjetor mbështetjen financiare për aktivitetet e Ekipit për të Drejtat e Fëmijës dhe zbatimin e aktiviteteve në Planin e Punës trevjeçar nën përgjegjësinë e këtij subjekti. Në këtë drejtim, përqindja e buxhetit duhet të përcaktohet në baza vjetore. Kjo do të kontribuojë në financimin e qëndrueshëm të Ekipit, dhe do të mundësojë planifikimin dhe programimin më efektiv të tij, monitorimin e zbatimit të aktiviteteve dhe vlerësimin e arritjeve.

Akterët e tjerë të përfshirë në Ekipin për të Drejtat e Fëmijës duke përfshirë qendrën për mirëqenie sociale, shkollat, objektet e kujdesit shëndetësor, institucionet e sundimit të ligjit, Avokatin e Popullit, shoqërinë civile dhe organizatat ndërkombëtare do të ndjekin të njëjtën qasje dhe do të planifikojnë burimet njerëzore dhe alokimet buxhetore.

Rekomandim për anëtarët e ekipit sektorial

Në sektorin e kujdesit shëndetësor, akterët kryesorë përgjegjës përfshijnë departamentin komunal të shëndetësisë, qendrat e mjekësisë familjare, Institutin për Shëndet Publik dhe spitalet. Detyra e tyre do të jetë mbledhja e të dhënave bazë dhe informacionit për shëndetin e nënës dhe fëmijës, si dhe të krijojnë lidhje me Planet e Veprimit të zhvilluara nga qendrat e mjekësisë familjare me planin e punës të ekipit të ardhshëm komunal për të drejtat e fëmijës. Aktivitetet për imunizimin, funksionalizimin e shërbimit të infermierisë komunitare, futjen e kontrollit të rregullt sistematik shëndetësor me parashkollorët dhe nxënësit e shkollës duhet të përfshihen në planin e punës si prioritet.

Në sektorin e arsimit, roli kryesor i është caktuar drejtorisë komunale të arsimit, institucioneve parashkollore, shkollave fillore dhe të mesme. Sfidat kryesore janë kapacitetet e pamjaftueshme të objekteve parashkollore për të ofruar qasjenë arsim për të gjithë fëmijët në nevojë, veçanërisht në zonat rurale. Vlerësimi i nevojave për qasje në edukimin në fëmijëri të hershme është prioriteti që duhet përfshirë në Planin e Punës të Ekipit. Shërbimet e asistentit personal dhe asistentit pedagogjik duhet të futen dhe të përforcohen në të gjitha komunat. Futja e metodologjive bashkëkohore të mësimdhënies, avancimi i kushteve teknike dhe infrastrukturës shkollore së bashku me trajnimin bashkëkohor të mësimdhënësve duhet të përfshihen në planin e punës, si dhe përmirësimi i qasjes në arsimin joformal dhe cilësia më e mirë e aktiviteteve jashtë shkollës.

Akterët kryesorë të Ekipit në fushën e shërbimeve të mbrojtjes sociale, përfshijnë departamentin komunal për shërbime sociale, qendrat lokale për mirëqenie sociale dhe OJQ-të aktive si ofrues të shërbimeve të mbrojtjes sociale. Duhet të sigurohet qasja dhe cilësia e përmirësuar e shërbimeve për fëmijët në nevojë dhe familjet e tyre, më konkretisht nevojiten përpjekje për kujdes alternativ për fëmijët pa kujdes prindëror, shërbime të përditshme në komunitet, shërbime mbështetëse të jetesës së pavarur, këshillim-terapeutik dhe shërbimet social-edukative dhe të tjera. Drejtësia për fëmijët duhet gjithashtu të integrohet mes prioritetëve në Planin e Punës të Ekipit. Akterët kryesorë përfshijnë mekanizmat e drejtësisë për të miturit në gjyqësor dhe ofruesit e shërbimeve miqësore për fëmijët për fëmijët në konflikt me ligjin në bashkëpunim të ngushtë me policinë, shkollat, qendrat për mirëqenien sociale, shërbimin sprovues dhe institucionet korrektuese.

Mekanizma efektivë për pjesëmarrjen e fëmijëve duhet të krijohen dhe funksionojnë në shkolla, me organizatat e shoqërisë civile që avokojnë për të drejtat e fëmijëve dhe që zëri i fëmijëve të dëgjohet në të gjitha proceset e planifikimit dhe planifikimit komunal që janë të rëndësishme për mirëqenien e tyre.

Drejtoritë komunale për mjedis dhe planifikim hapësinor dhe OJQ-të sektoriale janë përgjegjëse për të integruar aspektet mjedisore në Planin e Punës, para së gjithash në sigurimin e qasjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara në të gjitha objektet, përfshirë ndërtesat, këndet e lojërave, infrastrukturën e trafikut dhe të tjera.

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijëve, në fushën e politikave dhe rregulloreve, ekipi pritët të ndihmojë komunën në përcaktimin e prioritetëve dhe masave për përmirësimin e vazhdueshëm të gjendjes

për fëmijët dhe zbatimin e aktiviteteve përkatëse në sektorët përkatës. Komuna do t'i krijojë të gjitha kushtet e nevojshme që ekipi për të drejtat e fëmijëve të kryejë aktivitetet e përcaktuara me Ligjin për mbrojtjen e fëmijëve.

Për të gjitha komunat rekomandohet themelimi i tryezave multidisiplinare për mbështetje në menaxhimin e rasteve të përbëra nga profesionistë sektorialë, në përputhje me nenin 21 të Ligjit për mbrojtjen e fëmijëve. Ato duhet të udhëhiqen nga menaxheri i caktuar i rastit, në koordinim dhe ndërveprim me përfaqësuesit e strukturave dhe shërbimeve komunale përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijëve.

